

Merr ndihmë

Albanian

Skillavëria moderne është shfrytëzimi i paligjshëm i qenieve njerëzore për përfitime tregtare ose personale. Ajo mund të përfshijë shfrytëzimin seksual, shfrytëzimin në familje, punën e detyruar, shfrytëzimin kriminal, apo edhe vjedhjen e organeve.

Ju mund të përjetoni një rënë prej situatave që janë përshkruar më sipër, por ndiheni në konflikt sepse miku juaj ose shefi juaj ju ka siguruar një punë dhe strehim.

Por në rast se përjetoni ndonjë nga situatat e treguara më poshtë, ose ndiheni sikur diçka nuk është si duhet, atëherë ajo nuk është SI DUHET. Ne jemi këtu për t'ju ndihmuar. Ne kemi oficerë të trajnuar që mund t'ju mbështesin dhe përkthyes nëse anglishtja nuk është gjuha juaj e parë. Në rast se nuk doni të flisni me një nga oficerët tanë të përkushtuar të policisë, atëherë në fund të kësaj fletë palosje mund të gjeni mbështetje ose ndihmë tjetër që është në dispozicionin tuaj.

- A ju kanë të detyruar të punoni kundër vullnetit tuaj ose të kryeni detyra për të cilat nuk keni rënë dakord?
- A ju kanë detyruar të punoni me orë më të gjata sesa mund t'ia dilni?
- A ndiheni të kërcënuar nga 'shoku' apo 'shefi' juaj?
- A ju mbajnë të izoluar prej të tjerëve?
- A ju zhvendosin nga një vend pune në tjetrin ose nga një shtëpi në tjetrën?
- A vareni nga shefi juaj për punën ose orët e punës, strehimin tuaj ose statusin e imigracionit?
- A ju thonë se çfarë jeni i lejuar të bëni dhe çfarë nuk ju lejohet të bëni?
- A ju bëhet një zbritje e pashpjegueshme nga paga juaj?
- A keni qasje ndaj dokumenteve të rëndësishme siç është pasaporta juaj? A jeni në gjendje të udhëtoni lirshëm?



**Kent
Police**

Contacting Kent Police

Report a non-urgent crime online www.kent.police.uk/report
Talk to us on LiveChat – available 24/7 www.kent.police.uk/contact
In an emergency, if crime is in progress or life is in danger call **999**
If deaf or speech impaired, text 'police' and your message to **60066**
www.kent.police.uk   